Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.I
Deçan,dt.29.01.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e I-rë të rregullt të KPF-së , me dt.27.01.2024.
Në mbledhje merrnin pjesë: 7 anëtar të KPF-së, drejtori i drejtorisë për BPZHR, Rifat Stojkaj, Besart Cacaj nga DKA, Edone Kameraj-Zyrtare për Informim.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Hajdar Sutaj.
Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Raportit një vjeçar të Kryetarit të Komunës.
3. Shqyrtimi i raportit analitik financiar për vitin 2023,
4. Shqyrtimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2024,
5. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe si dhe mbledhjeve të KPF-së për vitin 2024,
6. Shqyrtimi i Porpozim-Vendimit për ndarjen e parcelave për ndërtimin e tri çerdheve për fëmijë, në fshatin Gramaqel, Isniq dhe Strellc i Epërm.
7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për kontingjentin e tretë me lopë qumështore. Marrëveshja dhe aneks marrëveshja me OZHR "Mëshqerra"
8. Të ndryshme

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e parë të rregullt të KPF-së për vitin 2024, pastaj e prezantoj rendin e punës dhe e hapi debatin rreth tij, meqenëse nuk kishte të interesuar për debat, Kryesuesi e qiti në votim, rendi i punës miratohet njëzëri.
I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Miratohet procesverbali njëzëri.
II. Shqyrtimi i Raportit një vjeçar të Kryetarit të Komunës.
Hyri Dobrunaj ka propozuar që pikat nr.2 dhe nr.3 të përcillen për Kuvend pa debat, meqenëse nuk është askush në mbledhje për të dhënë sqarime.
III.Shqyrtimi i raportit analitik financiar për vitin 2023.
Njëzëri përcillen për kuvend dy raportet, pa debat.
IV. Shqyrtimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2024.
Kryesuesi e prezantoj Planin e punës së kuvendit për vitin 2024, në vazhdim e hapi debatin rreth tij.
Vatan Istrefaj- ka propozuar që Raporti i Auditorit të Jashtëm për NPL"Higjiena" të planifikohet në rend dite në muajin Maj ose Qershor.
Kryesuesi- e qiti në votim propozimin e Vatan Istrefaj, Raporti i Auditorit të Jashtëm për NPL"Higjiena" të hyn si pikë në mbledhjen e muajit Maj ose Qershor, propozimi miratohet në muajin Qershor.
Hyri Dobrunaj-thotë se në këtë plan asgjë nuk është planifiku sa i përket raportit të drejtorive me theks të veçantë, Raporti i realizimit të projekteve kapitale, Raporti i drejtorisë për Arsim dhe Raporti i Drejtorisë për Shëndetësi.
Kryesuesi-thotë se Kryetari ka deklaruar se unë si kryetar, përgjigjem në çështjet që i drejtohen Ekzekutivit, jo drejtorët dhe të gjitha raportet e të gjitha drejtorive hyjnë në raport të kryetarit dhe trajtohen në kuadër të raportit të kryetarit.

Rekomandim: antarët e KPF-së pas shqyrtimit të kësaj pike, planin e dërgojnë në Asamble për shqyrtim dhe miratim me ndryshimin që Raporti i Auditorit të Jashtëm për NPL"Higjiena" hë hyn në mbledhjen e muajit Qershor, me këtë ndryshim njëzëri përcillet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.
V.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe të KPF-së për vitin 2024.
Ishte propozim i anëtarëve të KPF-së që mbledhjet e kuvendit të mbahen të premten e fundit të çdo muaji.
Kryesuesi- ka thënë se do të përpiqemi që ti mbajmë të premten e fundit të muajit mbledhjet e kuvendit, por nuk di sa do të zbatohet kjo.
Rekomandim: U kërkua që me vendim mbledhjet e kuvendit të përcaktohen që të mbahen të premten e fundit të çdo muaji, Kryesuesi ka thënë se do të bëjmë përpjekje dhe do të angazhohem që mbledhjet e kuvendit të mbahen të premten e fundit të muajit por jo detyrimisht, Propozim Vendimi njëzëri përcillet për shqyrtim dhe miratim ne Kuvend pa ndryshime, atje debatohet prap.
VI. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarjen e parcelave për ndërtimin e tri çerdheve për fëmijë, në fshatin Gramaqel, Isniq dhe Strellc i Epërm.
Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë, Besart Cacaj, zyrtar i DKA-së, i cili ka sqaruar për propozimin e bërë nga Drejtoria Komunale e Arsimit për ndërtim të tri çerdheve për fëmij.
Hyri Dobrunaj-pyet, a kini bërë analizë dhe a dini sa fëmijë kini me i pasë aty.
Besart Cacaj- thotë se në fshatin Strellc parashihet që çerdhja të ketë kapacitet për 40 fëmijë.
Florim Mataj- pyet, kush është pronar i pronave që propozohet të ndahen për ndërtim të tri çerdheve, për të cilën Besart Cacaj përgjigjet se janë prona të shkollave përkatëse.
Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar këtë pikë dhe pas sqarimeve të dhëna nga zyrtari i DKA-së, Besart Cacaj, njëzëri i japin vizën për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e kuvendit.
VII. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për kontingjentin e tretë me lopë qumështore. Marrëveshja dhe aneks marrëveshja me OZHR "Mëshqerra".
Kryesuesi e ka prezentu piken pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë drejtorit , Rifat Stojkaj, i cili ka sqaruar se bëhet fjalë për 34,000.00€, për 100 fermer që kanë përfituar në dhjetor 2023.
Yllarta Thaqi- pyet, a mund të vazhdon prap ky aktivitet, sepse ka prap fermer të interesuar.
Drejtori, Rifat- përgjigjet se do të punojmë në këtë drejtim, jemi në negociata dhe të shohim nëse mund të arrijmë të jemi përfitues prap.
Vatan Istrefaj-pyet, sa është shuma e mjeteve që participin një qytetar..
Drejtori Rifat- qytetari participon me 400 euro, 1000 euro komuna, ndërsa pjesa tjetër organizata..
Hyri Dobrunaj- pyet,rreth marrëveshjes të cilën thotë ajo se e kemi pasë edhe para kësaj mbledhje, prandaj kërkoj njoftim a është program i ri apo i vjetri, poashtu për këtë çështje ishte dashtë të ish prezent në mbledhje Kryetari i Komunës për të dhënë sqarime, pasi që u tha më herët se Kryetari përgjigjet në pyetjet që ju drejtohen drejtorëve.
Drejtori, Rifat- sqaron se e kemi pasë marrëveshjen e vjetër dhe tash është aneks Marrëveshje, kurse kryetari asnjëherë nuk ka thënë, që ju drejtorët nuk mund të përgjigji për çështjet që bien në kuadër të drejtorive që i drejtoni..
Florim Mataj-thotë se kontingjenti i lopëve qumështore ka mbërri, na tash duhet vetëm mjetet financiare me i miratu, ndërsa drejtorin e përgëzoj për punën dhe angazhimet e tij, kurse kur bëhet fjalë për raportim, në momentin kur është kryetari prezent përgjigjet ai, kurse në mungesë të tij përgjigjet drejtori që është prezent për fushën e vet përkatëse.
Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar këtë pikë dhe kanë kërkuar sqarim nga drejtori i DBPZHR, Rifat Stojkaj, i cili ka thënë se mjetet financiare kërkohen për kontigjentin e lopëve qumështore, që janë shpërnda në muajin dhjetor 2023, dhe bëhet fjalë për 100 fermer që kanë përfituar, shuma që kërkohet për miratim nga komuna është 34.000 euro.Njëzëri përcillet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ

Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.II
Deçan,dt.26.02.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e II-të të rregullt të KPF-së , me dt.26.02.2024.
Në mbledhje merrnin pjesë: 7 anëtar të KPF-së, drejtoresha e drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, drejtori i drejtorisë për BPZHR, Rifat Stojkaj si dhe Bekim Vishaj.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Hajdar Sutaj.
Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i propozim- vendimit për ndarjen e 20,000.00 € për bashkëfinancim me organizatat joqeveritare në lëmin e bujqësisë.
3. Marrja e vendimit për ndarjen e 5,000.00 € për pagesën e donacionit për pajisjet e shkollave dhe QKMF.
4. Shqyrtimi i Draft- Planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë;
5. Të ndryshme

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e II-të të rregullt të KPF-së për vitin 2024, pastaj e prezantoj rendin e punës dhe e hapi debatin rreth tij.
Vatan Istrefaj-pyet, pse nuk ka ardhë si pikë e rendit të ditës, Marrja e vendimit për bartje të hyrave vetanake nga viti paraprak 2023 në vitin aktual fiskal 2024, meqenëse ka qenë si pikë e planifikuar në planin e punës së Kuvendit, për të cilën drejtoresha, Dafina, përgjigjet se ende nuk e ka dërgu shkresën Ministria me të cilën duhet të barazohemi paraprakisht me shumën e mjeteve që janë për barjte e pastaj duhet ta qesim në kuvend.
Hyri Dobrunaj- ka bërë vërejtje që nuk janë paisë me material të mjaftueshëm për pikën nr. 2 dhe nr.3
Kryesuesi e qiti në votim rendin e punës, i cili miratohet me 4 vota për(pozita) dhe 3 abstenim (opozita).
I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Miratohet procesverbali njëzëri.
II. Shqyrtimi i propozim- vendimit për ndarjen e 20,000.00 € për bashkëfinancim me organizatat joqeveritare në lëmin e bujqësisë.
Kryesuesi e ka prezentu piken pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë drejtorit , Rifat Stojkaj, i cili fillimisht ka thënë se mi përkrahë bujqësinë sot është akt shum i mirë, pastaj ka sqaruar se bëhet fjalë për ndarjen e 20,000.00€, dhe se jemi në negociata me Organizatën Islamic Relief Kosovo, për bashkëpunim në projekte zhvillimore në fushën e bujqësisë e këtë radhë bëhet fjalë për 50 sera, që kushtojnë nga 1500 euro, mirëpo fillimisht kërkohet që komuna të ndanë mjetet financiare ku tregohet se sa jemi të gatshëm te participojmë në këtë projekt, e pastaj vinë projektet.
Yllarta Thaqi- thotë se prap jam skeptik sa i përket kësaj teme, është mirë me përfitu fermerët dhe për këte të gjithë pajtohemi, por me letra nuk e ki plotësua materialin mjaftueshëm.
Hyri Dobrunaj- nëse kjo organizatë po don me bashkëpunu me ne, pse nuk na ki pru ni shkresë që e vërteton këtë fakt, sepse ne jemi mi zhvillu bujqësinë, por jo kështu pa letra, të jemi të qartë se ne jemi opozitë, por jemi mu zhvillu Deçani.
Drejtori, Rifat- edhe një herë sqaron se nuk mundesh me pasë projekt, pa pasë garanci financiare.

Faton Selmanaj-pyetje, kjo organizata islamike me të cilën je në bisedime e sqarove, mirëpo më intereson se a ka ndonjë organizatë tjetër përveç kësaj, kurse sa ju përket projekteve në lëmine e bujqësisë, ai tregon një foto të kanaleve të ujitjes në fshatin Isniq, që janë në atë fazë, ende të papërfunduara të projekteve kurse ato kanë filluar të dëmtohen.
Drejtori, Rifat- sqaron se sa ju përket kanaleve të ujitjes, Komuna e Deçanit asnjë kompetencë nuk e ka atje, Ministria i zhvillon të gjitha procedurat.
Florim Mataj- të përgëzoj drejtor për punën dhe angazhimet tuaja, sa i përket kësaj pike ka qenë mirë me pasë material pak ma shum, por unë jam për miratimin e kësaj pike.
Vatan Istrefaj- nëse vjen ni pikë për shqyrtim në KPF pa material, nuk është mirë, ne jemi për me i ndihmu fermerët, por kërkojmë letra.
Drejtori, Rifat- thotë se menjëherë tash mund të jau bi këtu e-mailin çka ka thënë organizata për këtë temë, pastaj drejtori i ka paisë antarët e KPF-së me shkresën me të cilën i ka zhvilluar negociatat me organizatën për mes E-mailit.
Yllarta Thaqi-pyet, a ndikon në buxhetin e projekteve të bujqësisë ndarja e 20,000 euro për këtë projekt, për të cilën drejtori përgjigjet se nuk ka ndikim.
KPF njëzëri i japin vizën për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e kuvendit.
III.Marrja e vendimit për ndarjen e 5,000.00 € për pagesën e donacionit për pajisjet e shkollave dhe QKMF.
Kryesuesi- e ka prezentu këtë pikë pastaj fjalën ia ka dhënë për sqarime drejtoreshës së drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet, Dafina Cacaj, ka thënë se bëhet fjalë për ndarjen e 5000 euro për transport të paisjeve për shkolla dhe për QKMF, të cilat janë donacion nga bashkatdhetari jonë në Suedi, Xhafer Balaj.
Yllarta Thaqi- pyet, në cilat shkolla shkojnë këto paisje.
Drejtoresha, Dafina-përgjigjet, ende nuk e dimë.
KPF njëzëri marrin vendim për ndarjen e 5,000.00 € për pagesën e transportit të donacionit për pajisjet e shkollave dhe QKMF, nga Suedia në Deçan.
IV. Shqyrtimi i Draft- Planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë.
Kryetari i Komisionit që ka hartuar Planin, Bekim Vishaj- ka sqaruar se është një dokument obligativ për Drejtorinë, për Kulturë, Rini dhe Sporte dhe përgjithësisht për komunën e Deçanit. .Plani i hartuar, ka thënë ai, është prezantim i gjendjes reale në Komunën e Deçanit, në fushën për të cilën është hartuar plani.
Yllarta Thaqi- fillimisht ju përgëzoj për përshkrimin e hyrjes, historikut, pozitës gjeografike dhe të dhënave tjera të Komunës së Deçanit, të cilat vërehet qartë se nuk janë përshkrim i bartur njejtë si në të gjitha dokunemtet tjera që na kanë ardhë këtë vit, por janë të studjuara dhe të përshtatura kushteve specifike të Deçanit, konkretisht për këtë plan.Në fq.5 mos është gabim, ni mulli është në Llukë që duhet të hyn këtu, Mejtepi në fshatin Llukë nuk është, për të cilën Bekimi sqaron se Mejtepi në fshatin llukë është në fq.9.
Florim Mataj- në dy pika objektet kulturore janë cekë, në fshatin Baballoq afër xhamisë është një tyrbe, poashtu në fshatin Baballoq janë 5-6 mullij që është mirë që të përfshihen në plan.
Bekim Vishaj- ne këtu i kemi nda me listë objektet e trashëgimisë kulturore që janë në mbrojtje të përkohshme, Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, ku hyn Manastiri i Deçanit dhe lista e objekteve të trashëgimisë kulturore që nuk janë në mbrojtje.
Faton Selmanaj- te objektivat duhet të jetë edhe Mbrojtja e Monumenteve të trashëgimisë kulturore,

fq.11 pejsazhi në fshatin Rastavicë, i cili veq është dëmtu krejt , e që unë disa herë e kam ngritë zërin dhe kam bërë edhe kërkesa për mirë mbajtje por askush nuk është marrë me te deri sa i kanë ra tash krejt degët Blinit dhe ka mbetë vetëm si trung, është rekomandim imi që duhet të jetë pikë e veçantë, Mbrojtja e Monumenteve të trashëgimisë kulturore, te dokumenti, Plani për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë.

Hyri Dobrunaj- ju përgëzoj për punën, te mullinjtë duhet të përfshihen të gjithë ata mullij që identifikohen, mirëpo kemi edhe shumë objekte tjera të trashëgimisë kulturore që nuk janë në mbrojtje nga ministria, dhe për këto objekte propozoj që të bëhet një planifikim i buxhetit që ato objekte që nuk janë në mbrojtje të Ministrisë të mbrohen nga komuna, dhe për këtë punë secili këshill i fshatit mu marrë me kete punë sepse hala ka objekte te trashëgimisë kulturore nëpër fshatra të cilat janë të paidentifikuara, prandaj edhe një herë kërkoj që të formohet një kod buxhetor në komunë për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore që nuk janë në mbrojtje të përkohshme të Ministrisë.

Yllarta Thaqi- kërkon që në fq.12 të shkruhen me emra kush janë Ushqimi tracional dhe produktet vendore.

Florim Mataj- ka ngritë çështjen e kullës së Hamëz Mataj në fshatin Baballoq, e cila është e dëmtume shum dhe paraqet rrezik të madh për të gjithë qytetarët që kalojnë aty, prandaj kërkon që të insistohet të bëhet diçka që mos të shembet krejt, sepse është shumë rrezik..

Hyri Dobrunaj- te trashëgimia shpirtnore a kish pasë mundësi mu ba një libër i veçantë ku i pëmbledhë të gjitha nga trashëgimia shpirtnore.

Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar këtë pikë dhe pas sqarimeve të dhëna nga zyrtari Bekim Vishaj, i cili ka thënë se do të përfshihen në plan të gjitha propozimet e KPF-së që vlerëson Komisioni se duhet të hyjnë në plan si dhe propozimet nga debati publik, KPF njëzëri i japin vizën për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e kuvendit të dt.29 Shkurt.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ

Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.III
Deçan,dt.26.03.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e III-të të rregullt të KPF-së , me dt.26.03.2024.
Në mbledhje merrnin pjesë: 6 anëtar të KPF-së (mungon Armend Loshaj), drejtori i Drejtorisë për Administratë, Jashar Dobraj, drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, Zyrtarja për Informim, Edone Kameraj.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Hajdar Sutaj.
Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raport i Komisionit për zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave;
3. Kërkesë e Kryetarit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për mbështetje të projektit "Digjitalizimi i Memorialeve të Dëshmorëve në Glllogjan";
4. Të ndryshme

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e III-të të rregullt të KPF-së për vitin 2024, verifikoj pjesëmarrjen e anëtarëve të KPF-së, në të cilën merrnin pjesë 6 anëtarë (mungon Armend Loshaj) dhe konstatoj se ka kuorum të mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes, pastaj e prezantoj rendin e punës dhe e hapi debatin rreth tij, meqenëse nuk kishte të interesuar për debat, Kryesuesi e qiti në votim rendin e punës, i njëjti miratohet njëzëri.
I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Faton Selmanaj-kërkon që të bëhet korrigjim, te fjala e tij, në fillim të fq.3, fjalia e korrigjuar duhet të jetë me këtë tekst: është rekomandim imi që duhet të jetë pikë e veçantë, Mbrojtja e Monumenteve të trashëgimisë kulturore, te dokumenti, Plani për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë.
Miratohet procesverbali njëzëri, me korrigjimin te fjala e Faton Selmanaj.
II. Raport i Komisionit për zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave.
Kryesuesi- e ka prezentu këtë pikë pastaj fjalën ia ka kaluar Kryesuesit të Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale, Jashar Dobraj, i cili ka sqaruar për punën e bërë nga komisioni dhe zgjedhjen e 19 Këshillave Lokale, ndërsa ka mbete pa u zgjedhë edhe Këshilli i fshatit Strellc për arsye se ata nuk janë dakorduar përbrenda vetevetes si komunitet, sepse komisioni ka zhvilluar takim aty por nuk kanë arrite të bëjnë zgjedhjen e Këshillit të fshatit për shkak të mospajtimeve brenda komunitetit, ai është shprehur se si komision janë të gatshëm të mbajnë takim në fshatin Strellc kurdo që ata dakordohen për këte gjë, ndërsa si komision janë pajtuar për zgjedhjen e Këshillit të fshatit Lëbushë si i vetëm meqenëse kanë llogaritur që ta bashkojnë me fshatin Strellc por nuk kanë hasë në mirëkuptim me fshatin Strellc, kurse në fshatin Isniq, si opcion i mundshëm për ta bashkuar edhe fshatin Lëbushë, veq ishin krye zgjedhjet, në vazhdim ai ka thënë se çdo veprim i komisionit është i pasqyruar në materialin që i është bashkëngjitur këtij raporti, pastaj ka shtuar se edhe në këto këshilla lokale mungon përfaqësimi gjinor por jo për fajin e komisionit.
Vatan Istrefaj-thotë se si komision e kini bërë një punë të mrekullueshme por mos zgjedhja e Këshillit lokal në fshatin Strellc nuk është punë e mos angazhimit të komisionit, por është punë e lokalitetit që nuk kemi mujtë mu dakordu mes veti.

Kryesuesi i Komisionit, Jashar Dobraj- kur do që organizohen fshati Strellc, ne jemi të gatshëm me marrë pjesë në takim dhe me i ba zgjedhjet.
Hyri Dobrunaj- vlerëson punën e komisionit, pastaj shton se sa i përket përfaqësimit gjinor kemi pasë ngecje gjithmonë edhe atëherë kur është bërë zgjedhja e parë e Këshillave lokale, pjesë e komisionit që ka qenë ajo vet.
Kryesuesi- e kalojmë si temë për shqyrtim në Kuvend, njëzëri KPF e kalojnë si pikë për shqyrtim në mbledhjen e kuvendit të dt.29 Mars.
III.Kërkesë e Kryetarit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për mbështetje të projektit "Digjitalizimi i Memorialeve të Dëshmorëve në Glllogjan".
Kryesuesi- e ka prezentu kete pikë pastaj për sqarime fjalën ia ka kaluar drejtoreshës, Dafina Cacaj, e cila ka sqaruar se si do të kryhet kjo punë, unë e kam një mostër ka thënë ajo që vendoset te varri i çdo dëshmori dhe lexohen të dhënat e tij në mënyrë digjitale, kjo punë do të kryhet deri me 5-6 maj kur është Dita e Dëshmorëve të Komunës së Deçanit.
Yllarta Thaqi- ka propozuar që të bëhet digjitalizimi i varrezave të gjithë Dëshmorëve të Komunës së Deçanit, mos të bëhet ndarje selektive, ajo thotë, unë e kam siguru listën e krejt dëshmorëve të Komunës së Deçanit që në total janë 247 Dëshmorë, dhe nëse nuk digjitalizohen të gjithë nuk është mirë.
Drejtoresh Dafina- thotë se kjo kërkesë tash është vetëm për dëshmorët e Gllogjanit.
Hyri Dobrunaj- thotë se edhe unë dashta me thanë ate që tha Yllarta, digjitalizimi të bëhet për të gjithë dëshmorët, dhe si projekt edhe sot kërkoj që të quhet Digjitalizimi i Memorialeve të të gjithë Dëshmorëve të Komunës së Deçanit, mos të ndahen.
Florim Mataj- edhe unë jam për digjitalizim të varrezave të gjithë dëshmorëve por këtë herë këto në Gllogjan, meqenëse ka ardhë kërkesa, e pastaj të vazhdohet me të tjerat dhe mos të mbetet pa u përfshi askush.
Faton Selmanaj- edhe unë pajtohem, ashtu si tha Hyria te termi Digjitalizimi i Memorialeve të gjithë Dëshmorëve të Komunës së Deçanit, dhe mi qitë një thirrje publike sepse ka plot tjerë përveç këtij djalit që e kemi sot në kërkesë, që e bëjnë këtë punë.
Florim Mataj- ta marrim vendimin sot për këte kërkesë që e kemi, e mbledhjen tjetër vazhdojmë me tjerat.
Kryesuesi- e qiti në votim kërkesën e Kryetarit të Komunës, për digjitalizim të memorialëve të gjithë Dëshmorëve të Komunës së Deçanit, me të cilën sot do të miratohet për fazën e parë në Gllogjan në shumën prej 2000 euro, pastaj mbledhjen tjetër vazhdojmë me dëshmorët tjerë në vazhdim, njëzëri miratohet kërkesa në shumën prej 2000 euro faza e parë.
IV. Kërkesa e Shkelzen Hadergjonaj për mbështetje financiare në shumën prej 5000 euro për projektin e ndërtimit të shtëpisë për aktivitetet e fshatit Prokolluk.
Hyri Dobrunaj- pyet, a është Shkelzeni kryetar i fshatit, dhe nëse është kryetar i fshatit për mua është okej, jam për, por nëse nuk është kryetar i fshatit të vjen kërkesa prej kryetarit të Këshillit të fshatit dhe e shqyrtojmë.
KPF kërkojnë që kërkesa të vjen nga Kryetari i Këshillit të fshatit dhe e shqyrtojmë mbledhjen tjetër.
IV.Të ndryshme, nuk ka tema për shqyrtim.
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Holluni

Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ

Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.IV
Deçan,dt.26.04.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e IV-të të rregullt të KPF-së , me dt.26.04.2024.

Në mbledhje merrnin pjesë: 6 anëtar të KPF-së (mungon Hyri Dobrunaj), drejtori i Drejtorisë për Administratë, Jashar Dobraj, drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, Zyrtarja për Informim, Edone Kameraj.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2024;
3. Ridestinim i mjeteve buxhetore nga Mallra dhe Shërbime në Subvencione;
4. Raporti i mbledhjes së parë të vitit 2024 të KKSB-së;
5. Shqyrtimi i propozim vendimit për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Dhunën në Familje;
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e IV-të të rregullt të KPF-së për vitin 2024, verifikoj pjesëmarrjen e anëtarëve të KPF-së, në të cilën merrnin pjesë 6 anëtarë (mungon Hyri Dobrunaj) dhe konstatoj se ka kuorum të mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes, pastaj e prezantoj rendin e punës dhe e hapi debatin rreth tij, meqenëse nuk kishte të interesuar për debat, Kryesuesi e qiti në votim rendin e punës, i njëjti miratohet njëzëri.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Miratohet procesverbali njëzëri pa vërejtje.

II.Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2024.

Florim Mataj- propozon që të përcillet për kuvend, atje debatohet rreth tij.

Vatan Istrefaj-kërkon sqarim për pagesat te Zyra e Kuvendit, çka janë Shërbime konsulentë, pagesa në shumën prej 1868 € dhe pagesa prej 3800€ nga Mallra dhe shërbime.

Yllarta Thaqi- kërkon sqarim te shpenzimet në zyrë të kuvendit.

Drejtoresha, Dafina Cacaj- sqaron se janë pagesa të komisioneve që janë paguar nga mallra dhe shërbime te Zyra e kuvendit, për të njëjtat dokumentacionin komplet do ta sjelli në Kuvend ka thënë ajo.

Rekomandim:KPF e kanë shqyrtuar raportin financiar për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2024, ku është kërkuar sqarim për disa nga shpenzimet, pas sqarimeve të dhëna nga drejtoresha, Dafina Cacaj, raporti përcillet për shqyrtim në kuvend, dokumentet për pagesat e komisioneve prezentohen në Kuvend nga drejtoresha Dafina..

III.Transferim i mjeteve buxhetore nga Mallra dhe Shërbime në Subvencione.

Kryesuesi- e ka prezentu piken, pastaj për sqarime fjalën ia kalon drejtoreshës, Dafina Cacaj, e cila sqaron se bëhet fjalë për pagesën e 85 euro cent për Ndërmarrjen Higjiena, për të cilat kuvendi ka

marrë vendim që të paguanë komuna për Tarifën e konsumatorëve shtëpiak-amvisëri, ku qytetari paguan 6 euro ndërsa komuna është zotuar se do ti mbulon shpenzimet prej 85 cent.
Vatan Istrefaj thotë, a ka mundësi N."Higjiena" mi pru një raport qe tregon saktë se janë ba këto shpenzime., kërkon faturë të specifikume qe janë bërë 50.000 euro shpenzime, ai shton se edhe atëherë kur është miratuar në kuvend nuk kam qenë i pajtimit për këto 85 cent, pastaj kërkon që përfaqësuesit e N."Higjiena" të vijnë me raport në kuvend sepse nuk është respektuar rregullorja për Shërbime Publike në këtë rast.
Faton Selmanaj- kërkon sqarim deri kurë vlenë kjo mënyrë e pagesës, e cekur në faq.2. ku thotë "Kjo mënyrë e pagesës vlenë deri në një vendim tjetër të Kuvendit".
Drejtoresha, Dafina- thotë, se ju e kini miratua , unë vetëm e kam zbatua.
Vatan Istrefaj- propozon që të rishikohet ky vendim dhe të hiqen krejt ato 85 cent.
Florim Mataj- jam dakord që ta ftojmë përfaqësuesit e N."Higjiena" dhe ta paraqesin një plan si do të funksionon kjo çështje sepse edhe kështu nuk shkohet.
Drejtoresha, Dafina, sqaron se borgji për faturat është ma i madh se 80.000 euro, por për momentin ti ndajmë këto 50.000 euro.
Rekomandim: KPF e shqyrtuan kërkesën nga Zyra e kryetarit, me të cilën kërkohet transferim i mjetëve buxhetore në shumën prej 50.000 euro nga kategoria Mallra dhe shërbime në Subvencione, të nevojshme për pagesën e faturës për NPL "Higjiena" në shumën prej 85 euro cent për çdo faturë në muaj, te kategoria e konsumatorëve shtëpiak-amvisëritë, nga buxheti i komunës së Deçanit, sipas vendimit të Kuvendit të dt.29.12.2022. Gjatë debatit u tha se kjo tarifë duhet të rishikohet ose të hiqet 85 cent dhe te mbetet 6 euro pagesa në muaj, te kategoria e konsumatorëve shtëpiak-amvisëritë. Pas shqyrtimit, KPF këtë pikë njëzëri e përcjellin për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.
IV.Raporti i mbledhjes së parë të vitit 2024 të KKSB-së;
Rekomandim: Njëzëri kalon si pikë për shqyrtim në Kuvend , pa debat.
V.Shqyrtimi i propozim vendimit për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Dhunën në Familje;
Rekomandim: Njëzëri kalon si pikë për shqyrtim në Kuvend , pa debat.

VI.Shqyrtimi i kërkesave.

1.Kërkesa e Shkumbin Malaj, në emër të komunitetit të fshatit Strellc i Epërm, për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve për aktivitetin e dhurimit të gjakut në fshatin Strellc i Epërm, i cili mbahet me dt. 25 Maj, shuma e kërkuar1,000.00€.
2.Kërkesa e komunitetit të fshatit Carrabreg i Epërm, për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve për aktivitetin e dhurimit të gjakut në fshatin Carrabreg i Epërm, i cili mbahet me dt.29 Maj, shuma e kërkuar1,500.00€.
Anëtarët e KPF-së, pas shqyrtimit këto dy kërkesa i miratojnë njëzëri.
3.Kërkesa e Riza Tolaj, kryetar i Këshillit të fshatrave Prilep dhe Prekolluk, në emër të banorëve të fshatit Prekolluk, , kërkesa e dt.23.04.2024, nr.01-12723, për ndarjen e mjeteve financiare , në shumën prej 5,000.00 euro për projektin e ndërtimit të shtëpisë së përbashkët për aktivitetet e fshatit Prekolluk.
Drejtoresha, Dafina, shprehet se unë jam për, nëse ju e miratoni, vetëm duhet gjete mënyra si ta bëjmë pagesën.
Florim Mataj- thotë se jam për miratimin e kësaj kërkese, por me kërkesa të njëjta kanë me na ardhë të gjitha fshatrat që kanë këtë nevojë.
KPF njëzëri miratojnë kërkesën prej 5000 euro, për ndërtimin e shtëpisë së përbashkët të fshatit Prekolluk.
4.Kërkesë nga Lidhja e Historianëve të Kosovës "Ali Hadri" dega në Deçan, në shumën 6509 euro.
Rekomandim: KPF e shqyrtuan kërkesën dhe meqenëse shuma e kërkuar i kalon limitet e miratimit nga KPF, ata e përcjellin kërkesën për shqyrtim në Kuvend, atje debatohet dhe vendoset për të.
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.
Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ

Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.V
Deçan,dt.28.05.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e V-të të rregullt të KPF-së , me dt.28.05.2024.

Në mbledhje merrnin pjesë: 7 anëtar të KPF-së, drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, Isuf Demhasaj, nga drejtoria për Shërbime Publike, shefja, Gentiana Mazrrekaj, Zyrtarja për Informim, Edone Kameraj.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Plani për menaxhimin e fatkeqësive natyrore;
3. Raporti i Komisionit për Emërtimin e rrugëve, Shesheve dhe Hapësirave tjera Publike;
4. Shqyrtimi i kërkesave
5. Të ndryshme

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e V-të të rregullt të KPF-së për vitin 2024, verifikoj pjesëmarrjen e anëtarëve të KPF-së dhe konstatoj se 7 anëtarët e KPF-së janë të pranishëm në mbledhje, pastaj e prezantoj rendin e punës dhe e hapi debatin rreth tij, meqenëse nuk kishte të interesuar për debat, Kryesuesi e qiti në votim rendin e punës, i njëjti miratohet njëzëri.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Miratohet procesverbali njëzëri pa vërejtje.

II. Plani për menaxhimin e fatkeqësive natyrore;

Kryesuesi- e prezantoj këtë pikë, pastaj e hapi debatin rreth saj.

Vatan Istrefaj- ka thënë se edhe pse është qitë në rend dite si pikë: Plani për menaxhimin e fatkeqësive natyrore, këtu plan nuk kemi, vetëm Propozim-Vendim për formimin e grupit punues për hartimin e Planit për Vlerësimin e Rrezikut në territorin e Komunës së Deçanit.

Hyri Dobrunaj-këtu në propozim- vendim kuvendi nuk është pjesëmarrës fare dhe nuk di pse ka ardhë në kuvend sepse nuk është dashtë të vjen në kuvend ky propozim vendim kështu.

Yllarta Thaqi- edhe unë mendoj se pika e rendit të ditës dhe materiali i prezantuar për këtë pikë nuk janë në koordinim me njëri tjetrin dhe nuk është dashtë të na vijnë në këtë formë.

Faton Selmanaj- edhe si pikë është emërua keq.

Florim Mataj- duhet të bëhet ndryshim te formulimi i pikës së rendit të ditës, si: Propozim-Vendim për formimin e grupit punues për hartimin e Planit për Vlerësimin e Rrezikut në territorin e Komunës së Deçanit.

Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar këtë pikë dhe kanë pasë vërejtje te formulimi i pikës së rendit të ditës si: Plani për menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe materialit të dërguar për këtë pikë si: Propozim-Vendim për formimin e grupit punues për hartimin e Planit për Vlerësimin e Rrezikut në territorin e Komunës së Deçanit. KPF janë pajtuar që këtë pikë ta përcjellin për shqyrtim në Kuvend, me formulim të ri, sipas materialit të prezantuar për të, si :

Propozim-Vendim për formimin e grupit punues për hartimin e Planit për Vlerësimin e Rrezikut në territorin e Komunës së Deçanit, me këtë riformulim të pikës së rendit të ditës, njëzëri e përcjellin për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit të dt.31.05.2024.

III.Raporti i Komisionit për Emërtimin e rrugëve, Shesheve dhe Hapësirave tjera Publike;

Kryesuesi e ka prezantuar piken pastaj e ka hapë debatin në KPF.

Vatan Istrefaj- edhe ky nuk është raport por vetëm si njoftim është, pastaj ka shtruar pyetjen si janë procedurat për ndryshim të emrit të një rruge.

Kryesuesi i KPF-së, në cilësinë e kryesuesit të Komisionit për emërim të rrugëve, ka sqaruar lidhur me materialin e dërguar për punën e bërë nga komisioni, të cilat janë të cekura në Njoftim, si dhe për procedurën e ndryshimit të emërit të një rruge, për të cilën ka thënë se emri i ri hyn në listën Rezervë të emrave të rrugëve por ndryshimi mund të bëhet vetëm pas vitit 2029, sepse kështu është përcaktuar me ligj.

Hyri Dobrunaj- pyet, a ka caktuar kritere komisioni për emërim të rrugëve.

Kryesuesi- përgjigjet, jo, sepse Ligji Nr.04\L-071, për Sistemin e Adresave dhe Udhëzimi Administrativ MMPH Nr.14/2019 për Caktimin e Emërtimit dhe Numërtimit të Adresave për Zona të Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi dhe Parcela Kadastrale të Lira, i ka caktuar qartë të gjitha kriteret dhe nuk lejon kritere shtesë.

Faton Selmanaj- thotë se ka rrugë që ju ka ndryshu emri por tabela nuk është ndryshuar, pse ka ndodhë kjo, kërkon sqarim.

Florim Mataj-është mirë tabelat të rregullohen, aty ku ka ndryshime, pastaj ka kërkuar njoftim kush është ka merret në komunë me këtë punë, si dhe a ju ka dhënë kontrata dikuj për tabelat e emrave të rrugëve.

Gentiana Mazrrekaj- thotë se tash janë planifiku mjetet por tender ende nuk ka për ndërrim të tabelave.

Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar këtë pikë dhe kanë pasë vërejtje te formulimi i pikës së rendit të ditës si: Raporti i Komisionit për Emërtimin e rrugëve, Shesheve dhe Hapësirave tjera Publike;dhe materialit të dërguar për këtë pikë si: Njoftim për punën e Komisionit për Emërtimin e rrugëve, Shesheve dhe Hapësirave tjera Publike. KPF janë pajtuar që këtë pikë ta përcjellin për shqyrtim në Kuvend, me formulim të ri, sipas materialit të prezentuar për të, si :

Njoftim për punën e Komisionit për Emërtimin e rrugëve, Shesheve dhe Hapësirave tjera Publike, me këtë riformulim të pikës së rendit të ditës, njëzëri e përcjellin për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit të dt.31.05.2024.

IV.Shqyrtimi i kërkesave.

1.Kërksa e Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim- Marrëveshja e bashkëpunimit mes CDF-it, Komunës së Deçanit, Pejës dhe Klinës.

Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, Isuf Demhasaj- ka sqaruar lidhur me kërkesën e drejtorisë për përkrahje financiare të Marrëveshjes së bashkëpunimit mes CDF-it, Komunës së Deçanit, Pejës dhe Klinës, ku nga komuna e Deçanit kërkohet që kjo marrëveshje të përkrahet me 3000 euro, ndërsa lider në këtë marrëveshje është Klina..

Vatan Istrefaj- Marrëveshja e nënshkruar thotë se pagesa duhet të bëhet në Mars, a mos jemi të vonuar këtu.

Hyri Dobrunaj- marrëveshja më ka pëlqye, por meqë jemi vonë me kohën e përcaktuar në marrëveshje, kjo është keq menaxhim dhe nuk dalim serioz si komunë.

Vatan Istrefaj- a jini dalë serioz ju që nuk kini pagu në kohë, përndryshe si marrëveshje e përkrahi.

Faton Selmanaj- marrëveshja paska ardhë me dt.25 korrik 2023, kërkon sqarim pse deri tash nuk ka dalë në KPF.

Drejtori, Isuf, sqaron se tash janë zhvillu procedurat në të gjitha komunat.
Njëzëri miratohen 3000 euro për Marrëveshjen e bashkëpunimit mes CDF-it, Komunës së Deçanit, Pejës dhe Klinës.
2.Kërkesa nga Drejtoria e SHFMU "Rexhep Kadrijaj" Rastavicë- Blerim Selmonaj, drejtor, për përkrahje financiare prej 4500 euro, për përgaditje, lekturim, dizajnim dhe printim të librit "Shkolla e Rastvicës 1928-2023".
Hyri Dobrunaj- për mendimin tim kjo kërkesë është rast precedent dhe nëse përkrahet atëherë çdo shkollë do të vjen me nga një kërkesë të tillë.
Drejtoresha, Dafina- thotë se nuk ka mjete financiare, mirëpo si komunë mund të ja bëjmë printimin e një numri të caktuar të ekzemplarëve të saj, te kompania që kemi kontratë.
Kryesuesi- e qiti në votim kërkesën e Drejtorisë së SHFMU "Rexhep Kadrijaj" Rastavicë, për përkrahje financiare prej 4500 euro, për përgaditje, lekturim, dizajnim dhe printim të librit "Shkolla e Rastvicës 1928-2023", anëtarët e KPF-së njëzëri e miratuan ate.
3.Kërkesë nga Lidhja e Historianëve të Kosovës "Ali Hadri" dega në Deçan, në shumën 6509 euro.

Rekomandim: kjo kërkesë është shqyrtuar në muajin maj, mirëpo meqenëse shuma e kërkuar i kalon limitet e miratimit nga KPF, ata e përcjellin kërkesën për shqyrtim në Kuvend, atje debatohet dhe vendoset për të.
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ

Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.VII
Deçan,dt.29.07.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e VII-të të rregullt të KPF-së , me dt.29.07.2024.

Në mbledhje merrnin pjesë: 6 anëtar të KPF-së (mungon Florim Mataj), drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, drejtori i Drejtorisë për Arsim, Besnik Hulaj, Anëtar të grupit punues për hartimin e PZHK të Arsimit, Zyrtarja për Informim, Edone Kameraj.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raporti gjashtëmujor i Kryetarit të Komunës;
3. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor financiar;
4. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm për vitin 2023 dhe Plani I veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit,
5. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor të Komitetit të Komuniteteve;
6. Shqyrtimi i Draft-Planit Zhvillimor të Arsimit 2024-2027;
7. Rialokim i mjeteve financiare në kategorinë e investimeve kapitale;
8. Shqyrtimi i kërkesave;
9. Të ndryshme.

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e VII-të të rregullt të KPF-së për vitin 2024, verifikoj pjesëmarrjen e anëtarëve të KPF-së dhe konstatoj se 6 anëtarë të KPF-së janë të pranishëm në mbledhje (mungon Florim Mataj), pastaj e prezantoj rendin e punës dhe e hapi debatin rreth tij, meqenëse nuk kishte të interesuar për debat, Kryesuesi e qiti në votim rendin e punës, i njëjti miratohet njëzëri.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Mungon, vjen për shqyrtim dhe miratim mbledhjen e radhës.

II. Raporti gjashtëmujor i Kryetarit të Komunës;

Kryesuesi- e prezantoj këtë pikë, mirëpo meqenëse nuk kishin ardhur në mbledhje për ta mbrojtur këtë temë Kryetari ose Nënkryetari i Komunës, u propozua që kjo pikë të hiqet edhe nga rendi i ditës të mbledhjes së Kuvendit, të dt.31.07.2024, me 3 vota (H.Dobrunaj, V.Istrefaj dhe F.Selmanaj) pro heqjes nga rendi i ditës së KPF-së dhe Kuvendit, 2 abstenime(H.Sutaj, A.Dobraj)1 kundër heqjes (Y.Thaqi), u vendos që kjo pikë mos të shqyrtohet sot dhe të hiqet edhe nga rendi i ditës të mbledhjes së Kuvendit, të dt.31.07.2024.

III. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor financiar.

Kryesuesi- e ka prezentu këtë pikë, pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë drejtoreshës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, e cila ka dhënë sqarime rreth raportit të prezantuar.

Vatan Istrefaj- ka kërkuar që forma e përpilimit të raportit të kthehet në formën qysh ka qenë përpara, sepse kështu nuk po kuptohet.

Drejtoresha, Dafina-përgjigjet, vet e kini kërku kështu në detaje.

Hyri Dobrunaj- qëllimi jonë është mi ditë sa janë paguar për çdo pagesë të shpenzuar, por kështu si ka ardhë është gabim.

Në vazhdim ajo ka shtruar fillimisht pyetjen se sa kanë mbete pa u shpenzua nga buxheti i përgjithshëm komunal i dedikuar për investime kapitale pas marrjes së mjeteve buxhetore me procedurë të vendimeve gjyqësore, mirëpo edhe nga të hyrat nuk kishte mbetur asgja është shprehur ajo.
Faton Selmanaj-njejtë mendoj edhe unë për raport, është mirë të vjen i detajumë, ndërsa fq.3 kolona3 pyet, çka paguhet kujdestari jasht orarit të punës, për të cilën sqaron, Drejtoresha Dafina.
Faton Selmanaj-pyet për Shtesa tranzitore-Zyra e Kryetarit, telefoni mobile-Zyra e Kryetarit, te Zyra e Kuvendit përvoja e punës e di që është hjekë, pyet rreth shpenzimit Kompensim brenda vendit, Shërbime të kanalizimit-ujësjellësit pyet çka është ky shpenzim, Te Drejtoria e SHP-kompensim brenda vendit(sqarim), te Shërbimet rezidenciale-kodi 75722 shtesa për të zgjedhurit.
Drejtoresha, Dafina-sqaron, te shpenzimi telefoni mobile e kemi paguar borgjin e grumbulluar për shumë kohë për të cilën kemi marrëveshje me postën për krejt punëtorët, por edhe te shpenzimi shërbime të kanalizimit është pagesë për obligim i vjetër.
Hyri Dobrunaj- raportin detal në kuvend me na pru.
Vatan Istrefaj-te drejtoria Buxhetit – furnizim për zyre-54.000 euro(sqarim).
Drejtoresha Dafina-te këto shpenzime paguhet shpenzimet edhe të drejtorive tjera, është edhe shpërndarja e faturave të tatimit në pronë.
Vatan Istrefaj-përmbarime Gjyqësore-sqarim për 525858 euro.
Drejtoresha-përgjigjet janë borgje që i ka marrë kompania "Lika".
Borgjin total të komunës e kemi 877,000.00 euro.
Yllarta Thaqi- te kultura-furnizimet e pastrimit sqarim për 2872.75 €, 800 € transfer social për individ, te Zyra e kryetarit-Mirëmbajtje rutinore-18,575€(sqarim).
Drejtoresha Dafina- përgjigjet se i kemi dy kontrata në bazë të cilave paguajmë vazhdimisht.
Hyri Dobrunaj- a nënkupton kjo që për këtë vit si komunë nuk kemi ma mjete me shpenzu, ndërsa shton se për me mujtë me funksionu duhet me planifiku ndryshe, përmbaruesi i ka marrë mbi katër milion, prandaj shtroj pyetjen sa buxhet i komunës është shpenzu këtu vetëm për ndëshkime.
Drejtoresha Dafina- për seancë ndëshkimet.
Hyri Dobrunaj-ky raport është ma i keqi deri me tani.
Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar raportin , në të cilin kanë pasë vërejtje për shumë shpenzime dhe kanë kërkuar sqarime, për të cilat ka sqaruar Drejtoresha, Dafina Cacaj. KPF njëzëri e përcjellin për shqyrtim në kuvend raportin, atje kërkohet të prezantohet edhe raporti detal financiar.
IV. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm për vitin 2023 dhe Plani I veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.
Kryesuesi e ka prezentu këtë pikë pastaj e ka hapë debatin rreth saj.
Hyri Dobrunaj-Raporti i Auditorit e thotë saktë ate që unë e kam thënë këtu vitin e kaluar dhe nuk kam çka me shtu ma tepër.
Drejtoresha Dafina- raporti është pasqyrim e drejtë i gjendjes ekzistuese, opinioni nuk ka ndryshua dhe kjo për shkak të tri të gjeturave kryesore, në vazhdim ajo ka dhënë shumë sqarime rreth raportit, ajo ka thënë se prej 17 të gjeturave, 8 të gjetura janë përmirësua, por janë shtua tri të reja.
Vatan Istrefaj- janë nënshkrua kontrata nga Kryetari pa pasur buxhet siç është kontrata për Pishinë Gjysmë Olimpike dhe Lloti nr.3.
Drejtoresha Dafina-thotë për këto ne kemi pasur marrëveshje paraprake.
Rekomandim:KPF e kanë shqyrtua raportin e auditorit të jashtëm, për të cilin Opinioni i auditorit nuk ka ndryshu nga ai i vitit paraprak, anëtarët e KPF-së kanë shtruar një varg pyetjesh për të cilat ka sqaruar drejtoresha, Dafina Cacaj, pas shqyrtimit ata njëzëri raportin e përcjellin për shqyrtim në Kuvend.

V.Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor të Komitetit të Komuniteteve.
Rekomandim: KPF njëzëri i rekomandojnë kuvendit që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës me arsyetimin, për mungesë të personit zyrtar përgjegjës për ta mbrojtë këtë temë.
VI. Shqyrtimi i Draft-Planit Zhvillimor të Arsimit 2024-2027.
Kryesuesi- e ka prezentu këtë pikë pastaj fillimisht për sqarime fjalën ia ka dhënë drejtorit të Drejtorisë për Arsim, Besnik Hulaj, i cili ka sqaruar për mënyrën e hartimit të planit, përmbajtjen e planit si dhe të dhëna tjera lidhur me këtë draft-plan, ai ka dhënë sqarime edhe për realizimin e PZHK-së së Arsimit që veç i ka skaduar mandati për të cilin ka thënë se 85% e tij është realizuar në praktikë.
Hyri Dobrunaj- ka vlerësuar se ky dokument si draft-plan është i mirë, pastaj i ka shtruar pyetje drejtorit lidhur me deklarimin e tij se 85% e PZHK së Arsimit është realizuar, ka kërkuar sqarime konkrete si është bërë realizimi i tij. Në vazhdim ajo i ka shtruar pyetje drejtorit se cili plan mundet me u realizua pa buxhet, si dhe cili është plani për drejtimet deficitare në arsim.
Drejtori- përgjigjet se të gjitha këto janë të cekura në plan dhe janë në proces të realizimit një pjesë e madhe e tyre.
Faton Selmanaj-Riorganizimi i rrjetit shkollor, shtimi i Çerdheve për fëmijë, duke kërkuar që në fshatin Isniq të bëhet ndërtim i çerdhes së re.
Drejtori, Besnik- thotë se e kemi bërë një kërkesë në Ministri të Arsimit, por na kanë refuzua Ministria këtë kërkesë me arsyetimin se nuk lejohet ndërtimi i një çerdhe të tillë.
Faton Selmanaj-ka mungesë të kuadrit arsimorë të drejtimeve deficitare si psh. matematika, si do të veprohet për këto raste.
Drejtori- thotë, nuk ka kuadër të mjaftueshëm, se nuk janë të interesuar me shku në matematikë.
Hysen xx- njëri nga anëtarët e Grupit punues për hartimin e draft-PZHK të arsimit ka dhënë sqarime të hollësishme rreth përmbajtjes së këtij draft-plani, ai ka thënë se çdo gjë që përfshihet në këtë draft ka bazë në Ligjet dhe Rregulloret ekzistuese që rregullojnë fushën e arsimit.
Vatan Istrefaj- te investimet në Strellc, ku parashihet ndërtimi Çerdhes për fëmijë, ka shtruar pyetjen se ku do të ndërtohet pasi që shkolla e vjetër ku parashihet të bëhet është në mbrojtje të trashëgimisë kulturore.
Drejtori- sqaron, se në fushë të sportit do të ndërtohet me kapacitet për 60 fëmijë.
Vatan Istrefaj- pyet, cila është cilësia në shkolla, si dhe a ka politizim në shkolla.
Hysen xx- përgjigjet se nuk kamë vërejtë se ka politizim në shkolla.
Enver Osdautaj, anëtar i Grupit punues- sqaron rreth situatës në arsim, kushtet dhe mënyrën e punës, mes tjerash ai ka thënë se mburrem me suksesin e nxënësve tonë në garat ndërkombëtare, mirëpo pak problem mbetet bashkëpunimi me prindër, mirëpo në plan janë parapa të gjitha ndryshimet.
Yllarta Thaqi- te fuzionimi i shkollave, shprehja tepricë teknologjike, a mund të zëvendësohet me tekst tjetër, shtron pyetjen, a e kini parapa mësimin tërë ditorë, si dhe ka kërkuar që në kuvend të raportohet lidhur me mbajtjen e testit dhe rezultatet e tij.
Hyri Dobrunaj-sa i përket politizimit tregon fakti që i kemi pasur mbi normat, ka kërkuar që në konkurse të ju epët përparësi femrave më të reja, dhe në fund ajo e ka përfunduar diskutimin duke thënë, faleminderit për dokumentin e hartuar, uroj të zbatohet në praktikë.
Kryesuesi- e qiti në votim Draft- Planin Zhvillimor të Arsimit 2024-2027, KPF njëzëri i japin vizën këtij dokumenti për shqyrtim në Kuvend.
VII. Rialokim i mjeteve financiare në kategorinë e investimeve kapitale.
Kryesuesi- e prezantoj piken pastaj fjalën ia kaloj drejtoreshës se buxhetit për sqarime.
Drejtoresha, Dafina- sqaron se bëhet fjalë për mjetet e planifikuara në vlerë 150,000.00 euro, në projektin "Objekti i ri i komunës" dhe rialokimin e tyre në dy projekte ekzistuese.

Vatan Istrefaj- pyet, a mbyllet ndërtimi i 4 urave me 40,000.00 euro.
Drejtoresha, jo, por edhe vitin tjetër mbyllet.
Kryesuesi e qiti në votim, anëtarët e KPF-së njëzëri e përcjellin për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit të dt.31.07.2024, me të cilin parashihet që nga projekti ekzistues "Ndërtimi i Objektit të Ri të Komunës, në të cilin është e planifikuar shuma prej 150,000.00 € nga Të Hyrat Vetanake.
Të Rialokohen në projektet ekzistuese:

1. "Ndërtimi i 4(katër) Urave për Roshkodol dhe Parku i fshatit Isniq", Vlera 40,000.00€, dhe
2. Projekti"Ndërtimi i Qendrës së Kolonive , Qendrës Rinore, Parqeve, Shesheve etj" Vlera 79,358.00€.

VIII.Shqyrtimi i kërkesave.
1.kërkesa për pagesën e shpenzimeve të anëtarëve të Kuvendit të bëra me rastin e vizitës studimore në qytetin e Gjirokastrës të realizuar nga data 24-26 Maj 2024.
Kryesuesi e ka prezentu kërkesës për ndarjen e mjeteve financiare për shpenzimet që kanë bërë anëtarët e kuvendit me rastin e vizitës studimore në qytetin Gjirokastër, vizitë e planifikuar edhe me planin e punës së Kuvendit, ku sipas faturave të prezantuara kërkohen të ndahen:
-Akomodimi dhe transporti sipas Faturës Nr.11/2024 të Firmës MIROCI REISE SH.P.K. të dt.27.05.2024, në shumën prej 3,900.00 €, dhe
- Pije dhe ushqimore sipas Faturës SHA-103-2024 të NTP Tropikal-Deçan, të dt.28.05.2024, në shumën prej 684.24 €.
Vatan Istrefaj thotë spo më duket reale shuma prej 684 euro për pije, nuk është e mundur.
Meqenëse nuk kishte diskutime tjera, Kryesuesi e qiti në votim, anëtarët e KPF-së e miratojnë atë me shumicë votash, rezultati i votimit ishte, 4 për (Kryesuesi, A.Loshi, F.Selmanaj, Y.Thaqi) 2 abstenim (H.Dobrunaj dhe V.Istrefaj).
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ

Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.VIII
Deçan,dt.30.08.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e VIII-të të rregullt të KPF-së , me dt.30.08.2024.
Në mbledhje merrnin pjesë: 6 anëtar të KPF-së (mungon Hyri Dobrunaj).
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Hajdar Sutaj.
Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i kërkesave;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e VIII-të të rregullt të KPF-së për vitin 2024, verifikoj pjesëmarrjen e anëtarëve të KPF-së dhe konstatoj se 6 anëtarë të KPF-së janë të pranishëm në mbledhje (mungon Hyri Dobrunaj), pastaj e prezantoj rendin e punës dhe e hapi debatin rreth tij, meqenëse nuk kishte të interesuar për debat, Kryesuesi e qiti në votim rendin e punës, i njëjti miratohet njëzëri.
I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Miratohet njëzëri pa vërejtje.
II. Shqyrtimi i kërkesave.

1.kërkesa e Komitetit të Komuniteteve për ndërtimin e një kanali në Lagjen Pemishte, në gjatësi rreth 250m.
Kryesuesi- e prezantoj kërkesën e Komitetit të Komuniteteve për ndërtimin e një kanali me gjatësi rreth 250m, në Lagjen Pemishte për sanimin e ujit rrjedhës i cili vie nga Suka e Baballoqit sa herë që ka të reshura atmosferike dhe e dëmton rrugën e asfaltuar, në vazhdim e hapi debatin rreth kësaj kërkese.
Florim Mataj-jemi për mi gjete një mundësi, por nuk kemi informata të mjaftueshme me kërkesën që na është drejtuar, prandaj propozoj që kërkesa të drejtohet te Drejtoria për Shërbime Publike.
Vatan Istrefaj- nuk jemi kundër por kërkesa si ka ardhë është e mangët, pa ndonjë parallogari dhe nuk dimë sa kushton, kjo kërkesë nuk është dashtë të adresohet në KPF.
Kryesuesi- t'i rekomandojmë drejtorisë për Shërbime Publike për shqyrtim dhe marrje të vendimit për këtë kërkesë.
KPF njëzëri kërkesën e drejtojnë për shqyrtim në Drejtorinë për Shërbime Publike.
2.Kërkesa e Komisionit për emërim të rrugëve dhe ndarja e mjeteve financiare për pagesën e mëditjeve të anëtarëve të komisionit.
Kryesuesi- e prezantoj kërkesën pastaj e hapi debatin rreth saj.
Vatan Istrefaj- nuk mendoj se është rruga e drejtë me ardhë kjo kërkesë në KPF, nuk jemi kundër që mu pagu ky komision, por jo me vendim të KPF.
Faton Selmanaj- e vlerësoj shumë punën e bërë nga Komisioni për emërim të rrugëve por nuk e di se me cilin ligj je tuj pagua komisionet.
Yllarta Thaqi- si komision nuk jemi pagu asnjëherë ma shumë se për 6 mbledhje sepse komisionet nuk paguhen ma shumë se 6 mbledhje brenda një viti.
Florim Mataj- edhe pse ka ardhë në KPF nuk është e kundërligjshme dhe sa për ne jemi okej.

Faton Selmanaj- nuk e kam të çartë pse me ardhë kjo kërkesë në KPF, prandaj për këtë arsye unë do të abstenoj.
Kryesuesi- e qiti në votim , anëtarët e KPF-së e miratojnë kërkesën e komisionit për emërim të rrugëve, për pagesën e mëditjeve të komisionit, në shumën prej 4650€, vendimi merret me shumicë votash, 5 votuan për, 1 abstenim (Faton Selmanaj).
3.Kërkesa Alban Berishës nga fshati Pozharë, për mbështetje financiare në shumën prej 5000 € për ndërtimin e kulmit të shtëpisë.
Kryesuesi- e ka prezentu kërkesën, pastaj e ka hapë debatin rreth saj.
Vatan Istrefaj- unë e kam lexu kërkesën, është e arsyeshme dhe jam pro.
Yllarta Thaqi- jemi për miratimin e kësaj kërkese, vetëm kërkojmë që të zbatohet.
Njëzëri miratohet kërkesa e Alban Berishës nga fshati Pozharë për ndërtimin e kulmit të shtëpisë në shumën prej 5000 euro.
III.Të ndryshme.
Nuk ka.
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ

Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.IX
Deçan,dt.24.09.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e IX-të të rregullt të KPF-së, me dt.24.09.2024.

Në mbledhje merrnin pjesë: 6 anëtar të KPF-së (mungon kryesuesi i KPF-së, Hajdar Sutaj), drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, Isuf Demhasaj, Shefja e Drejtorisë për Shërbime Publike, Gentiana Mazrrekaj, Zyrtarja për Informim, Edone Kameraj.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, z.Florim Mataj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Buxhetit për vitet 2025-2027;
3. Raporti gjashtëmujor i Kryetarit të Komunës(materialin e kini nga mbledhja e kaluar);
4. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor të Komitetit të Komuniteteve(materialin e kini nga mbledhja kaluar);
5. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore;
6. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën deri në një vit;
7. Shqyrtimi i Draft-Strategjisë për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027;
8. Njoftim i Drejtorisë për Arsim për përgatitjen e vitit shkollor 2024/2025;
9. Shqyrtimi i kërkesave;
10. Të ndryshme.

Kryesuesi i mbledhjes, Florim Mataj- e hapi mbledhjen e IX-të të rregullt të KPF-së për vitin 2024, verifikoj pjesëmarrjen e anëtarëve të KPF-së dhe konstatoj se 6 anëtarë të KPF-së janë të pranishëm në mbledhje (mungon kryesuesi i KPF-së, z.Hajdar Sutaj), pastaj e prezantoj Rendin e punës bashkë me kërkesën financiare të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 2,986.58 euro, për pjesëmarrjen e Komunës së Deçanit në Panairin Ndërkombëtarë të Turizmit dhe Sportit, që u mbajt me dt.16 dhe 17 Prill 2024, kërkesë e cila anëtarëve të KPF-së ju ka shkuar në formë elektronike pas materialit të mbledhjes, në vazhdim e hapi debatin rreth rendit të punës.

Hyri Dobrunaj- lidhur me kërkesën e drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, ka thënë që për çështje parimi dhe jo për ndonjë gjë tjetër jam kundër shqyrtimit, sepse siç e dini jemi dakorduar që kërkesat që nuk vijnë me material të mbledhjes mos të shqyrtohen.

Vatan Istrefaj- kemi thënë që kërkesat që vijnë pas datës 15 të muajit përkatës mos të shqyrtohen në mbledhjen e ati muaji.

Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, Isuf Demhasaj, ka dhënë sqarime lidhur me vonesën e ardhjes së materialit si dhe ka sqaruar për rëndësinë e pjesëmarrjes së Komunës së Deçanit në këtë panair.

Kryesuesi e qiti në votim rendin e punës bashkë me kërkesën e drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, i njëjti miratohet me shumicë votash, Hyri Dobrunaj abstenon.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Vatan Istrefaj- thotë se nuk kamë vërejtje te fjala ime por nuk është cekë fjala e kryesuesit ku ka dhënë arsyeshmërinë e kërkesës së Komisionit për emërim të rrugëve, e cila ka qenë shumë me rëndësi për miratimin e kësaj kërkese.
Faton Selmanaj- thotë se pyetja ime ka qenë se me cilin ligj je tuj pagua komisionet e jo pse me ardhë kjo kërkesë në KPF, siç është shkruar në procesverbal.
Hyri Dobrunaj- thotë se unë nuk kam qenë në mbledhje me qëllim, sepse muaji gusht është pushim dhe s'ka logjikë me mbajtë mbledhje.
Yllarta Thaqi- thotë se te procesverbali janë cituar pyetjet por nuk janë cekur edhe përgjigjet, unë kam thënë se komisionet nuk paguhen ma shumë se 6 mbledhje brenda një viti.
Drejtoresha, Dafina Cacaj-thotë se unë nuk kam qenë e njoftuar fare për mbledhjen e KPF-së të dt.30 Gusht, ndërsa sa i përket vendimit për pagesë të komisionit për emërim të rrugëve nuk ka pasë nevojë me dalë në KPF sepse çdo pagesë e komisioneve deri me tash është bërë me vendim të kryetarit edhe ky duhet të bëhet ashtu si kemi veprua deri me tani dhe nuk e di arsyen pse ka ardhë në KPF.
Hyri Dobrunaj- thotë se KPF në këtë rast ka marrë vendim për pagesën e komisionit për emërim të rrugëve dhe tash, a është nul ai vendim, ka pyet ajo.
Hyri Dobrunaj dhe Faton Selmanaj kanë bërë vërejtje pse është publikuar procesverbali i mbledhjes bashkë me ftesën pa u miratuar.
Kryesuesi i mbledhjes e ka qitë në votim procesverbalin me plotësime te vërejtjet e potencuara si dhe mos të publikohet procesverbali pa u miratua, Njëzëri miratohet procesverbali me plotësimet te vërejtjet e anëtarëve të KPF-së.
II. Shqyrtimi i Buxhetit për vitet 2025-2027;
Drejtoresha e Buxhetit, Dafina Cacaj- e ka prezantuar draft buxhetin për vitet 2025-2027, ku sipas Qarkores Buxhetore 2025/02 buxheti i Komunës së Deçanit për vitin 2025 është 14,401,935.00, për vitin 2026 total buxheti është 15,096,315.00, për vitin 2027 buxheti në total është 15,806,774.00€.
Vatan Istrefaj- pyetje, te projekti Blerja e veturave shuma 60.000 euro, sa vetura janë parapa, projekti Ndërtimi objektit te komunes – projekt i ri, Elektrifikimi I bjeshkës së Strellcit-projekt i ri, Çka po ndodhë me zbatimin e projektit Lloti nr.3, ka cekë projketin Ujësjellësi në Bjeshkë të Madhe, Lloti nr.4 çka përfshinë, ai ka bërë vërejtje pse parashikohen mjete buxhetore për ujësjellës në bjeshkë kurse nuk kemi në rrafsh nëpër fshatra uj hiq.
Drejtoresha, Dafina Cacaj- përgjigjet, te blerja e veturave, është parapa blerja e dy veturave, e kryetarit dhe e nënkryetarit, te Lloti nr.3 janë 200.000 euro, Lloti nr.4 vazhdon me asfaltim të rrugëve të fshatrave të cilat nuk janë përfshi në Llotin nr.3, menaxhimin e ujit nuk e bëjmë ne, Elektrifikimin në bjeshkë të Strellcit e kemi parapa si projekt që ta kemi si kod nëse kemi edhe ndonjë mundësi bashkëfinancimi.
Vatan Istrefaj- pyet, pse është ndërpre ndriçimi në fshatra, pse janë ndërpre punimet aty, në buxhet I kemi 3mil e 500.000 euro kapitale dhe 700.000 euro përmbarime si do te operoni me kte buxhet me keto permbarime.
Hyri Dobrunaj- sa I perket borxheve 6 mil. I kemi pase ne 6 mujorin e parë, pastaj ka cekë projektet Kompleksi Memorial për të gjithë dëshmorët e Deçanit dhe Ndërtimi I Lapiarëve në fshatra, qysh doni me I nda këto dy projekte pyet ajo, projekti Ndërtimi rrugës Mehmet Uka, por spo përputhet me rrugën Elez Geci sepse për rrugën Mehmet Uka janë planifiku shum mjete financiare krahasuar me rrugën Elez Geci që janë pak kurse gjatësia e rrugës është më e madhe krahasuar me rrugën Mehmet Uka.
Drejtoresha, Dafina- sqaron se Memoriali për gjithë Dëshmorët është parapa që të ndërtohet në Gllogjan, kurse memorialet e Dëshmorëve në fshatra janë, vazhdojmë në fshatratë ku nuk janë ndërtu deri tash., te rruga Mehmet Uka dhe rruga Elez Geci, rruga Elze Geci është regjionale dhe kemi mendu me bashkëfinancim ta kryejmë por për këtë duhet ta ketë kodin e vet.
Hyri Dobrunaj- pyet, kush e merr vendimin për ndërtimin e Memorialit në Gllogjan dhe si, për të cilën ka sqaruar drejtoresha, Dafina.

Faton Selmanaj-te kodet, te pjesa e kuvendit është zero te numri I puntorve dhe kërkon sqarim për këte dhe te Arsimi I mesem pse nuk është cekë numri I stafit.
Dafina sqaron se asamblistët janë në listë të pagave sepse paguhen, por nuk figurojnë në listë të numrit të puntorëve sepse janë me mandat nuk llogariten si staf civil kurse te arsimi numri I stafit janë bashkë te arsimi fillorë.
Faton Selmanaj- Asfaltimi I rrugës Belle, aty ka qenë një rrugë dhe për çfarë rruge bëhet fjalë tash".
, Ujësjellësi në Bjeshkë të Madhe-sqarim, ndërtimi I Sheshit qytetit –cili është pyet, ndërtimi I deponive inerte-ku është deponia.
Drejtoresha Dafina-sqaron për pyetjet e ngritura.
Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar draft buxhetin për vitet 2025-2027, ku sipas Qarkores Buxhetore 2025/02 buxheti i Komunës së Deçanit për vitin 2025 është 14,401,935.00, për vitin 2026 total buxheti është 15,096,315.00, për vitin 2027 buxheti në total është 15,806,431.00€.00€. Debati është koncentruar kryesisht te investimet kapitale ku janë bërë pyetje të ndryshme dhe janë kërkuar sqarime rreth projekteve të ndryshme te lista e investimeve kapitale, për të cilat sqarime ka dhënë drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj.KPF pas debatit e kanë përcjellë draft buxhetin për shqyrtim dhe miratim në Kuvend me shumicë votash, 3-për plus vota shtesë e kryesuesit të mbledhjes(Florim Mataj 1+1, Armend Loshaj, Yllarta Thaqi) 3-kundër (Hyri Dobrunaj, Vatan Istrefaj, Faton Selmanaj).

1. Raporti gjashtëmujor i Kryetarit të Komunës;

Kryesuesi i mbledhjes e prezantoj piken pastaj e hapi debatin në mbledhje.
Yllarta Thaqi-thotë se ky është raport i punës së drejtorive dhe nuk janë përfshi të gjitha punët që janë krye sepse janë krye punë shumë ma shumë se ato të cilat janë cekë në raport.
Rekomandim: KPF e përcjellin këtë pikë për shqyrtim në kuvend, pa debat, nëse nuk vjen Kryetari në mbledhje të Kuvendit rekomandojnë mos të shqyrtohet fare.

2. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor të Komitetit të Komuniteteve;

Rekomandim: KPF e përcjellin për shqyrtim në Kuvend, pa debat.

3. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore;

Kryesuesi e ka prezentu piken pastaj fillimisht për sqarime fjalën ia ka dhënë kryesueses së komisionit, Gentiana Mazrrekaj.
Gentiana Mazrrekaj, kryesuese e komisionit për vlerësim të dëmeve, mes tjerash ajo ka sqaruar se kanë qenë 41 kërkesa, 39 prej tyre janë miratua kurse 2 nuk i kanë plotësuar kushtet që kërkohet sipas legjislacionit në fuqi, raporti është hartuar për dëme të shkaktuara në muajtë Qershor dhe Korrik 2024.
Yllarta Thaqi- pyet- a i kanë marrë paret ata që janë dëmtu ma herët.
Gentiana-sa i përket raportit të vitit kaluar, Ministria i ka miratu me përjashtim të 4 kërkesave që kanë qenë dëmtime të shkaktuara nga ariu, sepse nuk i kanë konsideru si dëme natyrore, këto janë në procedurë të ekzekutimit.
Vatan Istrefaj- për ekonomitë familjare, nuk janë ekzekutu disa, pse ka ndodhë kjo.
Drejtoresha Dafina- sqaron se te unë kanë qenë dy kërkesa që janë miratu dhe ekzekutu.
Rekomandim:KPF e kanë shqyrtuar raportin, për të cilin sqarime ka dhënë Gentiana Mazrrekaj, kryesuese e komisionit për vlerësim të dëmeve, mes tjerash ajo ka sqaruar se kanë qenë 41 kërkesa, 39 prej tyre janë miratua kurse 2 nuk i kanë plotësuar kushtet që kërkohet sipas legjislacionit në fuqi, dëme të shkaktuara në muajtë Qershor dhe Korrik 2024. KPF pas shqyrtimit raportin e përcjellin njëzëri për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën deri në një vit;

Drejtoresha, Dafina- ka dhënë sqarime rreth draft rregullores së prezantuar, e cila i ka kaluar të gjitha procedurat e shqyrtimit edhe debatin publik por nuk ka pasë propozime për ndryshime, e njëjta është e bazuar në legjislacionin në fuqi.
Hyri Dobrunaj- pyet çka ka ndodhë me Fakrikën e Mjaltit të cilën e kemi dhënë në shfrytëzim, a ka paguar qira personi që e ka marrë në shfrytëzim.
Drejtoresha, Dafina- përgjigjet se qe tri vite që unë jam drejtoreshë nuk ka pagu dhe tash do ti ndjekim procedurat që parasheh ligji në rastet e tilla.
Rekomandim:KPF pas shqyrtimit këtë draft rregullore e përcjellin pa ndryshime në kuvend për shqyrtim dhe miratim, meqenëse i ka kaluar të gjitha procedurat e shqyrtimit.

5. Shqyrtimi i Draft-Strategjisë për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027;

Rekomandim:KPF pa debat e përcjellin për shqyrtim në kuvend, edhe pse në mbledhje të KPF-së mungonte propozuesja e këtij drafti, Ajne Iberhysaj.

6. Njoftim i Drejtorisë për Arsim për përgatitjen e vitit shkollor 2024/2025;

Drejtori i Drejtorisë për Arsim, Besnik Hulaj- ka dhënë sqarime .
Yllarta Thaqi- thotë e kini përdorë fjalën "rreth" te numri i nxënëse ku duhet të jetë numër i saktë jo "rreth".
Drejtori, Besnik- përgjigjet se është përdorë fjala "rreth" sepse deri në fund të vitit lëvizë numri i nxënësve.
Yllarta Thaqi- vlenë ende kërkesa ime e më hershme për veshjen e uniformave në shkolla, merrni model në Gjakovë ka thënë ajo.
Hyri Dobrunaj-thotë se më pëlqen propozimi që fëmijët të mbajnë uniforma në shkolla, mirëpo nuk bënë të diskutojmë në KPF dhe Asamble për këtë temë sepse është cenim i të drejtës së fëmijës.
Drejtori, Besnik Hulaj- thotë se ne e kemi debatuar këtë temë me drejtorët e shkollave dhe me Këshillin e prindërve dhe drejtorët kanë qenë "për" këtij propozimi por këshilli i Prindërve ka qenë kundër.
Vatan Istrefaj- pyet, sa po ndikon në procesin mësimor pajisja e librave, pyetje-digjitalizimi në shkolla si dhe kërkon sqarim rreth pajisjes me dru dhe pelet për ngrohje në shkolla.
Drejtori- përgjigjet, sa i përket digjitalizimit, kemi apliku por vetëm 7 shkolla kanë përfitu, për dru për nxemje është kthye tenderi i parë dhe sot besoj se del tenderi për së dyti, për libra- hala kemi nxënsa që nuk kanë libra.
Faton Selmanaj- lidhur me sigurinë në shkolla, a kanë dy shkollat e mesme siguri fizike, besoj se duhet me pasë ma shumë bashkëpunim me policinë sepse kam ndëgju se ka pasë përleshje të nxënësve në shkolla.
Drejtori- ka sqaruar rreth sigurisë në shkolla.
Rekomandim: KPF kanë debatuar lidhur me këtë pikë dhe kanë kërkuar sqarime, për të cilat sqarime ka dhënë drejtori i Drejtorisë për Arsim, Besnik Hulaj, pas debatit këtë pikë e përcjellin për shqyrtim në Kuvend.

IX.Shqyrtimi i kërkesave.

1.Kërkesa e Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 2,986.58 euro, për pjesëmarrjen e Komunës së Deçanit në Panairin Ndërkombëtarë të Turizmit dhe Sportit, që u mbajt me dt.16 dhe 17 Prill 2024.
Drejtori, Isuf Demhasaj ka dhënë sqarime rreth kësaj kërkese.
Anëtarët e KPF-së e kanë miratuar kërkesën e Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 2,986.58 euro, për pjesëmarrjen e Komunës së Deçanit në Panairin Ndërkombëtarë të Turizmit dhe Sportit, që u mbajt me dt.16 dhe 17 Prill 2024, vendimi është marrë me shumicë votash, 5 për, 1 abstenim-Hyri Dobrunaj, e cila ka deklaruar se po abstenoj vetëm për shkak të parimit, përndryshe jam për përkrahje të promovimit të Deçanit në panaire.
Kryesuesi i mbledhjes- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse, Dyke Llolluni

Kryesuesi i mbledhjes, Florim Mataj

Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.X
Deçan,dt.28.10.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e X-të të rregullt të KPF-së, me dt.26.10.2024.

Në mbledhje merrnin pjesë: 4 anëtar të KPF-së (mungojnë kryesuesi i KPF-së, Hajdar Sutaj, Yllarta Thaqi dhe Hyri Dobrunaj anëtare të KPF-së), drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, drejtori i Drejtorisë për Arsim , Besnik Hulaj, Zyrtarja për Informim, Edone Kameraj.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, z.Florim Mataj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Raportit nëntë mujor financiar;
3. Shqyrtimi i Draft-Planit Zhvillimor të Arsimit 2024-2027;
4. Shqyrtimi i kërkesave;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i mbledhjes, z.Florim Mataj- e hapi mbledhjen e X-të të rregullt të KPF-së për vitin 2024, verifikoj pjesëmarrjen e anëtarëve të KPF-së dhe konstatoj se 4 anëtarë të KPF-së janë të pranishëm në mbledhje (mungojnë:.Hajdar Sutaj, Yllarta Thaqi dhe Hyri Dobrunaj) dhe konstatoj se ka kuorum të mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes, pastaj e prezantoj Rendin e punës, në vazhdim e hapi debatin rreth rendit të punës.

Faton Selmanaj- ka thënë se në mbledhjen e fundit të kuvendit nuk është bërë si duhet transmetimi live i mbledhjes, sepse ka pasë shkëputje të transmetimit gjatë mbledhjes, e njëjta ka pasë mu transmetu ma vonë meqenëse na patë thanë ai djali se kanë pengesa dhe do ta transmeton ma vonë por kjo nuk është bërë, prandaj ka thënë ai kërkoj që ta shoh kontratën që e kemi ne si komunë me agjensionin që bënë transmetimin e seancave të Kuvendit.

Florim Mataj-po, atë ditë patë thanë se pjesa e cila nuk është transmetuar live gjatë mbledhjes për shkak të pengesave që kanë pasur do të transmetohet ma vonë.

Kryesuesi e qiti në votim rendin e punës, i njëjti miratohet njëzëri.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Faton Selmanaj- te asfaltimi i rrugës në Belle nuk kam thënë "kurë do të kryhet" por kam thënë"aty ka qenë një rrugë dhe për çfarë rruge bëhet fjalë tash".

Kryesuesi i mbledhjes e ka qitë në votim procesverbalin me plotësime te vërejtjet e potencuara. Njëzëri miratohet procesverbali me plotësimet te vërejtjet e anëtarit të KPF-së, Faton Selmanaj.

II. Shqyrtimi i Raportit nëntë mujor financiar.

Kryesuesi i takimit e prezantoj këtë pikë pastaj për sqarime fjalën ia kaloj drejtoreshës së drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj.

Drejtoresha, Dafina Cacaj- fillimisht është ndërlidhë te kompania e kontraktuar për transmetim live të seancave të Kuvendit, ajo ka thënë se ka vërejtje te ata që e bëjnë transmetimin e seancave si vijon: nën 1. Ata e binë vonë transkriptin e seancës paraprake të kuvendit, nën 2. Atë ditë e kanë ndërpre transmetimin e mbledhjes së kuvendit dhe nën 3. Nuk kanë ardhë ditën e Gështenjës për ta transmetuar organizimin "Dita e Gështjenjës", prandaj do t'i rishikojmë këto çështje me ta.

Vatan Istrefaj- pyet, te shpenzimet - Kompenzimet brenda vendit dhe çka përfshihet te Shërbime tjera, sa i përket shëndetësisë në QKMF nuk ka as shiringa, për shkak se përmbaruesi i ka marrë 67.000 euro, shpenzimet janë ndalë pak por kjo ka ndodhë sepse nuk kini pasë mjete ma shumë me shpenzu dhe a ka mundësi me na pru raportin qysh e ki pru gjithmonë deri para herës së fundit.
Drejtoresha Dafina- përgjigjet se "kompenzimet brenda vendit" janë drekat dhe pagesat e komisioneve.
Vatan Istrefaj- kërkoj që raporti me na ardhë i detajumë si përpara dhe kjo me qenë edhe si rekomandim i KPF-së për Kuvend..
Kryesuesi i takimit, Florim Mataj- ka thënë, ndoshta ligjërisht kështu duhet mi pru raportin drejtoresha.
Faton Selmanaj- kam vërejtje te kompania që transmeton seancat e kuvendit sepse disa janë ndërpre dhe nuk janë transmetu komplet asnjëherë edhe kërkesa ime është me na ardhë ai formati i raportit si na ka ardhë përpara.
Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar këtë pikë, ku janë shtruar pyetje të ndryshme për të cilat ka dhënë sqarime drejtoresha e drejtorisë për Buxhet dhe Financa, znj.Dafina Cacaj, është kërkuar sqarim se çka përfshihet në "kompenzimet brenda vendit", çka përfshihet në "shpenzimet tjera" si dhe ka pasë vërejtje se në QKMF mungojnë barna nga lista esenciale duke përfshi edhe shiringat, si dhe është rekomandim i KPF-së për kuvend që Raporti financiarë të vjen përsëri në formatin si ka ardhë përpara i detajuar, KPF raportin njëzëri e përcjellin për shqyrtim në kuvend, atje debatohet prap.
III.Shqyrtimi i Draft-Planit Zhvillimor të Arsimit 2024-2027.
Kryesuesi e ka prezentu Draft-Planin Zhvillimor të Arsimit 2024-2027, pastaj për sqarime fillimisht fjalën ia ka dhënë Drejtorit, Besnik Hulaj.
Drejtori, Besnik Hulaj- ka sqaruar se Draft-Plani Zhvillimor i Arsimit i ka kaluar të gjitha procedurat e shqyrtimit dhe është nxjerrë drafti final të cilin ju e kini në dispozicion, ndërsa në Kuvend do të vijnë edhe anëtarët e komisionit për hartimin e këtij plani, që të japin sqarime nëse dikush kërkon nga ata. Drejtori ka thënë se në Kuvend do të formohet komisioni për ndarjen e bursave dhe komisioni i ankesave për bursa të studentëve.
Vatan Istrefaj- a ka pasë ndonjë ndryshim gjatë shqyrtimit të këtij draft plani, edhe sa pret që të zbatohet ky plan sa i përket anës financiare.
Drejtori, Besniku- sqaron se disa punë të parapara në këtë plan janë krye, mirëpo ne kemi parapa vetëm ato punë që mundemi me i krye, që janë të kapshme financiarisht.
Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar Draft-Planin Zhvillimor të Arsimit 2024-2027, ku është kërkuar sqarim se a ka pasë ndryshime gjatë procedurës së shqyrtimit si dhe sa pret që të zbatohet ky plan nga forma financiare, për të cilin sqarime ka dhënë drejtori i drejtorisë për Arsim, z.Besnik Hulaj, mes tjerash ai ka thënë se ky dokument i ka kaluar të gjitha procedurat e shqyrtimit dhe drafti final është në shqyrtim tani, ndërsa në Kuvend do të vjen për ta mbrojtë si temë edhe Grupi punues-hartues i këtij draft-plani. KPF pa ndonjë propozim për ndryshim, njëzëri e përcjellin këtë pikë për shqyrtim në kuvend.
IV.Shqyrtimi i kërkesave.
Vatan Istrefaj- thotë, ishalla është hera e fundit se kjo nuk është hera e parë që kërkesat që i drejtohen KPF-së nuk vijnë për shqyrtim në KPF, sepse unë kam informata se ka pasë kërkesa për shqyrtim në KPF, kërkesa duhet me ardhë për shqyrtim në KPF ka thënë ai, qoftë edhe nëse ajo kërkesë është absurde.
Drejtoresha, Dafina Cacaj- thotë, çdo kërkesë realisht duhet me ardhë për shqyrtim te kryetari e pastaj me dalë në KPF nëse vlera e mjeteve financiare duhet miratuar në KPF.

3.Të ndryshme.
Vatan Istrefaj-kërkon që ti rekomandohet kuvendit që pika e rendit të ditës Të ndryshme, të del si pikë e parë e rendit të ditës sepse transparenca është më e madhe meqenëse në fillim të mbledhjes janë prezent Kryetari dhe drejtorët ndërsa në fund të mbledhjes rrallë se janë prezent në mbledhje.
Rekomandim: KPF i rekomandojnë Kuvendit që pika "Të ndryshme" të del si pikë e parë e rendit të ditës në mbledhjet e kuvendit, me arsyetimin se në fillim të mbledhjes janë prezent në sallë Kryetari dhe drejtorët dhe transparenca është më e madhe kur ngritën çështjet e ndryshme në fillim të mbledhjes dhe aty është Kryetari i Komunës për të dhënë sqarime bashkë me drejtorët.

Kryesuesi i mbledhjes- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse, Dyke Llolluni

Kryesuesi i mbledhjes
Florim Mataj

Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.XI
Deçan,dt.26.11.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e XI-të të rregullt të KPF-së, me dt.26.11.2024.
Në mbledhje merrnin pjesë: 6 anëtar të KPF-së (mungon Hyri Dobrunaj) drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, Zyrtarja për Informim, Edone Kameraj.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPS-së, z.Hajdar Sutaj.
Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Caktimi i normave tatimore për pronën e paluajtshme për vitin 2025;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e XI-të të rregullt të KPF-së për vitin 2024, verifikoj pjesëmarrjen e anëtarëve të KPF-së dhe konstatoj se 6 anëtarë të KPF-së janë të pranishëm në mbledhje (mungon Hyri Dobrunaj) dhe konstatoj se ka kuorum të mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes, pastaj e prezantoj Rendin e punës, në vazhdim e hapi debatin rreth rendit të punës.
Meqenëse nuk kishte të lajmëruar për debat, Kryesuesi e qiti në votim rendin e punës, i njëjti miratohet njëzëri.
I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Faton Selmanaj- te fjala ime në vend "Kompania" duhet të jetë "Agjensioni".
Vastan Istrefaj- te fjala ime pas tekstit"Nuk ka as shiringa" shtohet teksti "për shkak se përmbaruesi i ka marrë 67.000 euro"
Kryesuesi- e ka qitë në votim procesverbalin me plotësime te vërejtjet e potencuara. Njëzëri miratohet procesverbali me plotësimet te vërejtjet e Faton Selmanaj dhe Vatan Istrefaj.
II. Caktimi i normave tatimore për pronën e paluajtshme për vitin 2025;
Kryesuesi - e prezantoj këtë pikë pastaj për sqarime fjalën ia kaloj drejtoreshës së drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj.
Drejtoresha, Dafina Cacaj- ka sqaruar se është propozim i normave të njëjta tatimore me vitin e kaluar, sepse janë ma të ultat që parashihen me ligj.
Vatan Istrefaj- thotë se vitin e kaluar i kemi zbritë dhe e njëjta është mirë tash.
Kryesuesi- e qiti në votim propozimin për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme, i njëjti miratohet njëzëri pa vërejtje dhe përcillet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.
3.Të ndryshme.
Vatan Istrefaj-kërkon që të qitet në rend dite në mbledhjet e KPF-së edhe pika Shqyrtimi i kërkesave, sepse jam i informuar se ka pasë kërkesa që ju kanë drejtuar KPF-së për shqyrtim, ka qenë një kërkesë nga Endrit Januzaj e cila nuk ka ardhë këtu për shqyrtim.
Kryesuesi- ka thënë se nuk e kemi qitë si pikë të rendit të Ditës Shqyrtimi i kërkesave meqenëse nuk kemi pasë mjete financiare dhe nuk kemi pasë si mi qitë sepse edhe nëse miratohet këtë vit duhet me dalë prap për shqyrtim dhe miratim në vitin tjetër fiskal sepse ka të bëjë me mjete financiare.
Vatan Istrefaj- kërkon që në mbledhje të Kuvendit të jetë prezent Kryetari i Komunës, me arsyetimin se nuk kemi shumë pika të rendit të ditës dhe kemi mundësi me debatu me kryetarin për çështje të ndryshme.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse, Dyke Llolluni

Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ